



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
PRESIDENTI

V E N D I M

Nr. 468, datë 21.11.2022

“PËR

**CAKTIMIN E DATËS PËR ORGANIZIMIN E PROCEDURËS PËR HEDHJEN E
SHORTIT NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS, PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË
KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI, QË DO TË FUNKSIONOJË PËRGJATË
VITIT 2023”**

Në mbështetje të nenit 149/d, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 221, pikat 7 – 10, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar,

V E N D O S A:

Neni 1

Hedhja e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të realizohet ditën e hënë, datë 5.12.2022, ora 10.00, në sallën “Skënderbej”, në Institutin e Presidentit të Republikës, me adresë Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 1, Tiranë.

Procedura dhe shorti të organizohen në përputhje me rregullat e hollësishme të miratuara me Vendimin nr. 404, datë 25.11.2019, të Presidentit të Republikës, “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.

Neni 2

Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Institutit të Presidentit të Republikës, për publikimin e datës dhe orës së hedhjes së shortit, në faqen zyrtare të Institutit të Presidentit të Republikës dhe dërgimin e njoftimeve në adresë të institucioneve përkatëse.

Neni 3

Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Institucionit të Presidentit të Republikës, për ngritjen menjëherë të Sekretariatit Teknik për organizimin e procedurës për përzgjedhjen me short të anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, si edhe ndjekjen e procedurave të përcaktuara në Rregulloren “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, miratuar me Vendimin nr. 404, datë 25.11.2019, të Presidentit të Republikës.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

